



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 174/5 Prot.

Tiranë, më 12/3 / 2025

FTESË PËR OFERTË

Nr. 16/1, Datë 12.03.2025

Për

“BLERJE PAJISJE ELEKTRONIKE”

në kuadër të projektit “DERHE”, PROGRAMI “ERASMUS+”

DREJTUAR: TË GJITHË TË INTERESUARËVE PËR TË MARRË PJESË

Publikuar në website-n e Universitetit të Tiranës

Referimi ynë: Urdhër nr.16, datë 12.03.2025

Subjekti: Ftesë për ofertë me objekt **“Blerje pajisje elektronike”**

Të nderuar Zonja / Zotërinj,

Rektorati i Universitetit të Tiranës, në zbatim të projektit të financuar nga Programi ERASMUS+ për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”, për Programin Erasmus+ të financuar nga BE, në Grant Agreement nr.101128628-DERHE-ERASMUS-EDU-2023-CBHE, në kuadër të fushës së veprimit “Capacity Building in the field of Higher Education (E+CBHE), në zbatim të projektit “Digital Education Readiness in the field of Higher Education - DERHE”, në Ligjin nr.44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSh”, në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 8/1/b, si dhe në vijim të kërkesës së Fakultetit të Ekonomisë, përcjellë Administratorit nga DKSHPMJ me nr.prot.174/1, datë 21.01.2025 për blerje pajisje elektronike në kuadër të projektit, si dhe në vijim të Urdhrit të blerjes nr.16, datë 12.03.2025,

Ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt “Blerje pajisje elektronike” sipas specifikimeve teknike bashkëlidhur:

Buxheti/Budget:

Fondi limit i parashikuar është 36,278.00 (tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) Euro pa tvsh.

Nga kandidatët kërkohet që të bëjnë oferta financiare nën këtë buxhet maksimal.

Vendi dhe data e dorëzimit të ofertës/ Place and date of bid submission:

Aplikimet duhet të dorëzohen ekskluzivisht në autoritetin kontraktor në protokoll, në një zarf të mbyllur të vulosur dhe firmosur, në adresën:

Universiteti i Tiranës
Address: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave do të jetë data **25.03.2025, deri në ora 16:00 pm.**

Kriteret e përjashtimit/ Exclusion criteria:

Aplikuesit/edhe Ofertuesi i huaj, duhet të vërtetojnë se përmbushin situatat e renditura më poshtë duke plotësuar formularin e vetdeklarimit mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ligjore bashkëlidhur kësaj ftesë (shtojca 2):

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e thirrjes. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse” në rastin kur është person fizik/shpk.
 - b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) në rastin kur është person fizik/shpk,
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale,
 - d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Kriteret e përzgjedhjes/Selection criteria:

Operatorët ekonomik **duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur të vulosur/firmosur, me protokoll pranë autoritetit kontraktor, jo me vonë se data dhe ora e caktuar**, plotësimin e dokumentave si më poshtë (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur):

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Formulari i ofertës ekonomike, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur.
2. Formulari i vetdeklarimit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur.
3. Specifikimet teknike, të vulosura e nënshkruara.
4. Dokumenti mbi Ekstraktin e historikut të subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, i cili duhet të përfshijë objektin ose ekuivalentin e objektit të prokurimit, lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
5. Furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, vërtetuar nëpërmjet Faturave tatimore të shitjes me subjektet private ose me subjektet publike, ku totali i tyre të jetë me vlerë jo më të vogël se 40 % fondi limit.
6. Vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

Dokumentat e mësipërme duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre e të përkthyer. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Autoriteti Kontraktor në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 “Per faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, do pranojë të likujdojë vetëm fatura elektronike për shërbimin e marrë. Për dorëzimin e një fature tatimore OE fitues duhet të ketë:

- Kopje të certifikatës elektronike të fiskalizimit për tatim paguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të certifikatës elektronike të fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Kriteri i vlerësimit /Award criteria:

Çdo aplikant duhet të paraqesë ofertën në një zarf të vetëm të mbyllur, të vulosur.

Oferta fituese do të bazohet në parimin e ofertës së përgjegjësme (që plotëson kërkesat minimale të kualifikimit) me çmimin më të ulët.

Aplikanti fitues do të ftohet për lidhjen e kontratës.

Kohëzgjatja e kontratës/ Duration of contract:

Afati i realizimit të furnizimit, do të jetë 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nënkontraktimi / outsourcing:

Nënkontraktimi nuk është i lejuar.

Gjuha e tenderit / Tender language:

Oferta e tenderit dorëzohet në shqip. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Ofertat e tenderit të paraqitura në ndonjë gjuhë tjetër do të refuzohen automatikisht.

Draft Formulari i kontratës është bashkëlidhur.



FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Aplikantit: _____

Për: **Universitetin e Tiranës**

Projekt i financuar në kuadër të projektit "DERHE", programi "ERASMUS+"

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Blerje pajisje elektronike"**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) **Euro pa TVSh;**
2. Çmimi total i ofertës është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) **Euro me TVSh.** (nese aplikohet)

"Blerje pajisje elektronike"				Çmimi (pa tvsh)	Vlera (pa tvsh)	Modeli i ofruar, referuar specifikimeve teknike
Nr	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia			
1	Video conferencing ekuivalent me Owl Labs Meeting Owl 3-360-Degree	copë	1			
2	TV ekuivalent me SAMSUNG 55" QE55Q60BAUXXH	copë	1			

3	Skaner për dokumente ekuivalent me CZUR ET24 Pro Professional Book Scanner, 24MP Document Camera, 3rd Gen Auto-Flatten & Deskew Tech, A3 Document Scanner, 180+ Languages OCR, Support HDMI, for Windows/MacOS/Linux	copë	1			
4	Laptop ekuivalent me Lenovo V15 G4 Notebook	copë	15			
5	Video kamera ekuivalent me GoPro HERO10	copë	2			
6	Laptop (2 in 1 Detachable, lightweight, touchscreen) ekuivalent me Surface Pro 11	copë	2			
7	VR headset Ekuivalent me Meta Quest 3 128GB – (Breakthrough mixed reality - Powerful performance	copë	5			
8	VR Software ekuivalent me National Geographic Explore VR, ose VirtualSpeech – Learn Public Speaking in VR, Spatial – Productivity, Collaboration, Project Management, Meta quest + etj	copë	5			
9	Plan për një platformë AI ekuivalente me ChatGPT4 plus	copë	2			
10	Plan për ekuipe për menaxhim marke Platformë dizajni dhe komunikimi vizual ekuivalente me Canva pro for team	copë	1			
11	Paketë e avancuar softuerike për analizën e të dhënave cilësore dhe metodat e përziera -MAXQDA analytics pro	copë	2			
12	Pointer për Prezantim	copë	4			
13	Sistem Zëri	copë	1			
14	Robot	copë	5			
15	Projektor Mini i Lëvizshëm me Rezolucion 1080P	copë	1			
16	Stabilizues imazhi 3-Aksësh për GoPro Hero	copë	2			
17	Projektor 4K PRO-UHD me 2,800 Lumen, Projektor Smart me Android TV	copë	1			

18	Paketë burimesh (kursesh) online për bizneset ekuivalente me udemy business	copë	1			
19	Mjet për menaxhimin e projekteve ekuivalent me Microsoft Project Standard	copë	1			
	Çmimi Neto (Euro pa tvsh)				-	
	TVSH (%)				-	
	Çmimi Total (Euro me tvsh)				-	

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit _____

Shtojca 2

(Shtojcë për tu paraqitur nga Aplikanti)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë, i nënshkruari _____ në cilësinë e Administrtorit të _____, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i Aplikantit:	_____
Numri ID / NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Aplikanti nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv) në rastin kur është person fizik/shpk. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti deklaron se plotëson të gjitha termat e references/specifikimet, siç udhëzohet në ftesë, dhe merr përsipër të realizojë objektin në përputhje me to.

B: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

SPECIFIKIME TEKNIKE

“Blerje pajisje elektronike”

Nr.	Emri i Pajisjes	Specifikimet	Sasia
1	Video conferencing ekuivalent me Owl Labs Meeting Owl 3-360-Degree	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Kamera: Të ketë një fushë pamjeje prej 360 gradësh me një rezolucion dalës 1080p HD. Rrezja e kapjes së videos të jete 3 metra (ose 10 foot), që e bën të përshtatshme për dhoma të ndryshme takimesh. Mikrofoni: 8 mikrofona inteligjentë me formim sinjali omni-drejtues, të cilët ofrojnë një rreze kapjeje audio prej 5.5 metra që zërat të kapen qartë nga të gjitha këndet, edhe në dhoma të mëdha. Altoparlanti: Të ketë tre altoparlantë të ndërtuar për mbulim audio në 360 gradë, duke ofruar zë të qartë në dhomë. Niveli i daljes së altoparlantit është 80 db SPL. Përputhshmëria: Të integrohet pa probleme me platforma të njohura të video konferencës si Zoom, Google Meet, Slack, dhe të tjera, bëri të mundur përdorimin e lehtë në mjedise të ndryshme të punës. Sistemi i Inteligjencës: Një software i bazuar në AI që merr përditësime rregullisht për të përmirësuar funksionalitetet dhe të bëjë bashkëpunimin edhe më imersiv dhe përfshirës. Kjo përfshin aftësi si fokusi automatik tek folësi aktiv, zmadhimi inteligjent, barazimi i zhurmës, dhe mundësinë për të sinkronizuar pa tel me pajisje të tjera për mbledhje pa probleme. Funksionim Plug-and-Play, pa nevojë për softuer shtesë. Fleksibiliteti dhe Mbulesa: Pajisja mund të lidhet me disa pajisje për të mbështetur dhoma mbledhjesh të të gjitha madhësive. Kjo lejon vendosjen e kamerave brenda një distance prej 0.9-1.8 metra nga çdo person në dhomë, duke u dhënë pjesëmarrësve në distancë një përvojë të plotë imersive. Minimumi 2 vite garanci	1
2	TV ekuivalent me SAMSUNG 55" QE55Q60BAUXXH	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: TV 55 inç me panel VA dhe ndriçim anësor	1

		LED. Rezolucion 4K UHD (3840 x 2160 piksel) dhe mbështet një gamë të gjerë ngjyrash dhe HDR, duke përfshirë HDR10, HLG, dhe HDR10+ Adaptive. Televizori të ketë frekuencë freskimi 50/60 Hz dhe një indeks cilësie të imazhit prej 3100 PQI. Për sa i përket lidhshmërisë, të ketë portat HDMI, USB, Ethernet, dhe mbështet Wi-Fi dhe Bluetooth. Peshë 15.5 kg dhe dimensione pa mbështetje prej 1232.1 x 708.3 x 25.7 mm. Telekomanda e përfshirë Baza: E rregullueshme Mbështetje për Montim në Mur VESA: Po (200 x 200 mm) e Përfshirë Minimumi 2 vite garanci	
3	Skaner për dokumente ekuivalent me CZUR ET24 Pro Professional Book Scanner, 24MP Document Camera, 3rd Gen Auto-Flatten & Deskew Tech, A3 Document Scanner, 180+ Languages OCR, Support HDMI, for Windows/MacOS/Linux	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Skaner për dokumente me teknologji të avancuar për rregullimin automatik të faqeve dhe korrigjimin e tyre. Pajisja duhet të suportoje skanimin e dokumenteve në formatin A3 dhe të njohë tekstin në më shumë se 180 gjuhë përmes teknologjisë OCR. Të jetë i përshtatshëm për një gamë të gjerë përdorimesh, duke përfshirë ambientet edukative dhe profesionale. Tipi : Laser Skaner për dokumente dhe libra Procesori : 32-bit MIPS CPU • Thellësia e Ngjyrave: 24 Bit • Gjuhe në OCR: 180 • USB : USB 2.0 High-Speed • Sensor imazhi : CMOS • Rezolucion : 5696*4272 • Shpejtësia e Skanimit: Më pak se 1.5 sekonda për faqe Softuer i përfshirë Përpunueshmëria -Sistemi operativ ○ Windows (7 dhe me sipër) ○ macOS (10.11 dhe me sipër) ○ Aksesorët e Përfshirë: ○ Pedal për Këmbë: Mundëson kthimin e faqeve pa përdorur duart gjatë skanimit ○ Tapet Dokumentesh: Siguron pozicionimin e qëndrueshëm të materialeve gjatë skanimit ○ Drita Anësore: Redukton reflektimet për faqe të ndritshme ose objekte	1

4	Laptop ekuivalent me Lenovo V15 G4 Notebook	Periudha e garancisë: Minimumi 2 vite garanci Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Përmasat: H23.25, W35.97, D1.79cm. Weight 1.7kg. Procesor Intel Core i7 I7-1355U me 10 Core. Minimumu 5GHz shpejtesia procesori Minimumu 16GB RAM DDR4. Minimumu 512GB SSD storage. Operating System: Windows 11 15.6 inch screen me: High definition display. Full HD Display. Resolution 1920 x 1080 pixels. 3 ms response time. Refresh rate 60Hz. 178 degree viewing angle. Screen Type: TN. Brightness (Nits): 250. Anti-Glare Screen. Karta Grafike: Intel Iris Xe Shared graphics card. Portat: 1 USB 2.0 port. 2 USB 3.2 ports. 1 USB Type-C port. 2 USB Type-A ports. HDMI port. Headphones jack. Bluetooth. Wi-Fi enabled. Garancia: të paktën 2 vit ○ Të përfshirë Mouse të jashtëm wireless ○ Të përfshihet çantë kurri e lehtë e zezë në përputhje me modelin e laptopit ○ 3 Docking station të përfshirë i përshtatshëm për t'u transportuar	15
5	Video kamera ekuivalent me GoPro HERO10	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Sensori i Imazhit: Madhësia e Sensorit: CMOS i paspecifikuar Rezolucioni Efektiv: 23 Megapiksel Kapja e Fotove dhe Videove: Fotot: Rezolucioni Maksimal: 23MP (JPEG, RAW). Modaliteti Burst: Po Video: Rezolucioni Maksimal: 5.3K në 60 fps Rezolucione dhe Frame Rates të Tjera:	2

		4K në 120 fps 2.7K në 240 fps 1080p në 240 fps Formati i Regjistrimit të Videos: H.264 (HEVC) Ekrani: Ekran i Parë: LCD Ekran i Pasëm: LCD me Prekje (Rezolucioni: Deri në 1080p Webcam: Mund të përdoret si një webcam për konferenca video Stabilizimi: Teknologjia: HyperSmooth 4.0 (stabilizim elektronik i imazhit) Karakteristika: Nivelizimi i horizontit deri në 45 gradë Karakteristika të Tjera: Kontrolli me Zë TimeWarp 3.0 (video me laps kohor) Laps natës (laps kohor në dritë të ulët) Kapje RAW Lidhshmëria Wi-Fi dhe Bluetooth GPS (opsionale) Kartë microSD e përfshirë Sloti i kartës microSD e heqshme (në 256GB) Bateria: Tipi: Litium-Ion e rikarikueshme Kapaciteti: 1720mAh Koha e Përafërt e Përdorimit: Varion në varësi të përdorimit dhe rezolucionit Përmasat:	
		71.8 x 50.6 x 33.6 mm (2.83 x 1.99 x 1.32 in) Pesha: 153 gramë (5.4 oz) me bateri Periudha e garancisë: Minimumi 3 vite garanci Të jetë e përfshirë Memory Card 256GB dhe bateri e rikarikueshme	
6	Laptop (2 in 1 Detachable, lightweight, touchscreen) ekuivalent me Surface Pro 11	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Windows 11 Home Copilot+PC Deri në 14 ore bateri Ekran 13'' OLED ose LCD HDR Touchscreen PixelSense, Flow display	2

		2xUSB-c Porta Deri në 4K Camera & Video - Quad HD front-facing Surface Studio Camera 1440p Quad HD camera with ultrawide field of view 10MP Ultra HD rear-facing camera Windows Hello face authentication camera Wifi 7 Deri në 900 kg pesha maksimale Tastierë e përfshirë Laps i Përfshirë Docking station i përfshirë Procesori - Snapdragon® X Elite (12 Core), with OLED display NPU - Qualcomm® Hexagon™ with 45 trillion operations per second Grafika - Qualcomm® Adreno™ GPU Memorie – 64 GB RAM LPDDR5 Storage – 1TB Gen 4 SSD Periudha e mbulimit të garancisë “Warranty”: 3 Vjet	
7	VR headset Ekuivalent me Meta Quest 3 128GB – (Breakthrough mixed reality - Powerful performance	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: VR 128GB Procesor të avancuar Qualcomm Snapdragon XR2 Gen 2 për performancë të fuqishme dhe memorie 8GB LPDDR5 RAM. Ekranet panele LCD me rezolucion të lartë dhe optika pancake, te ofrojë një rezolucion prej 2064 x 2208 pikselë për sy Frekuencë rifreskimi deri në 120 Hz. Sistemi i gjurmimit brenda-jashtë me 6DOF qe siguron saktësi të përmirësuar, Kamerat me kalim ngjyrash që lejojnë përvoja të pasura të realitetit të përzier.	5
		Kontrollet te reja Ring-Free Touch Plus qe ofrojnë ergonomi të përmirësuar dhe përgjigje hapëse TruTouch. Të ketë gjithashtu Wi-Fi 6E për përvoja VR wireless me shpejtësi të lartë, Bluetooth 5.2, dhe jetëgjatësi baterie deri në 2.2 orë.Të pëshojnë rreth 515 gram.. Te ketë të përfshirë: Për Meta Quest 3, Quest 2/Pro, Pico 4, PC VR, Steam VR Kabllo i Dhënash me Shpejtësi të Lartë USB 3.0	

		- Kablllo Karikimi USB-C për Aksesorët e Kufjeve VR Specifikimet Kryesore: - Gjatësia: 16 ft (4.87 metra) – e mjaftueshme për lëvizje të lirë dhe përvoja zhytëse në VR. - Shpejtësia: USB 3.0 me transmetim të dhënash të shpejtësisë së lartë deri në 5Gbps, duke siguruar lidhje të qëndrueshme dhe performancë optimale për lojërat VR. - Kompatibilitet: Meta Quest 3, Quest 2, Quest Pro, Pico 4, PC VR dhe Steam VR. - Funksionalitet i Dyfishtë: Kablllo jo vetëm për transmetimin e dhënave, por edhe për karikim të njëkohshëm të kufjeve VR gjatë përdorimit. - Dizajni i Kablllit: - Material i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj përdorimit intensiv. - USB-C i përputhshëm me shumicën e kufjeve dhe pajisjeve moderne. Periudha e mbulimit të garancisë “Warranty”: 3 Vjet	
8	VR Software ekuivalent me National Geographic Explore VR, ose VirtualSpeech – Learn Public Speaking in VR, Spatial – Productivity, Collaboration, Project Management, Meta quest + etj	Karakteristika minimale teknike për VR. Software për VR që ofron një udhëtim edukative anembanë botës apo për menaxhimin e riskut nga katastrofat, menaxhim projektsh etj, për një periudhë dy vjeçare abonimi për 5 user. Software mund të përzgjidhet nga Metaquest+ katalog ose ekuivalent Software duhet te japin imazhe ne 3D	5
9	Plan për një platformë AI ekuivalente me ChatGPT4 plus	Karakteristika minimale teknike për planin: Kërkohet një abonim në një platforme AI për të lehtësuar përdorimin e përbashkët të platformës brenda organizatave dhe bizneseve për dy account për një periudhë 2 vjeçare. Ky plan duhet te ofroje mjete dhe modele të avancuara të AI-së, si dhe veçori të përshtatura për produktivitetin dhe sigurinë në grup. Karakteristikat kryesore: Modele dhe Mjete të Avancuara :Ekipet marrin qasje të vazhdueshme në modelet më të fundit të OpenAI, duke përfshirë: - GPT-4 team - DALL·E 3 për krijimin e imazheve	2

		○ Shfletim në internet ○ Analiza të avancuara të të dhënave 2. Hapësirë Bashkëpunimi: Një hapësirë e dedikuar ku anëtarët e ekipit mund të punojnë bashkërisht duke përdorur komunikim natyror me tekst, zë ose imazhe. 3. Siguria dhe Privatësia e të Dhënave: ○ Kontroll administrativ për menaxhimin e ekipit. ○ OpenAI që nuk trajnon modelet e saj duke përdorur të dhënat apo bisedat e organizatës tuaj. ○ Standardet e sigurisë janë të rrepta për mbrojtjen e informacionit.	
10	Plan për ekipe për menaxhim marke Platformë dizajni dhe komunikimi vizual ekuivalente me Canva pro for team	Karakteristika minimale teknike për planin: Një abonim për një periudhë tre vjeçare për një skuadër deri në 3 persona user platformë dizajni dhe komunikimi vizual, e cila fuqizon përdoruesit në mbarë botën të krijojnë dhe publikojnë një gamë të gjerë përmbajtjesh vizuale. Karakteristikat Kryesore: • Ndërfaqe Miqësore për Përdoruesin: të ofrojë funksionaliteti intuitiv "zvarrit dhe lësho" e bën procesin e dizajnit të thjeshtë dhe të aksesueshëm për përdoruesit e të gjitha niveleve. • Bibliotekë e Gjerë Shabllonesh: Të ofrojë mbi 8,000 shabllone falas, përdoruesit mund të krijojnë shpejt dizajne profesionale për qëllime të ndryshme, si postime në rrjetet sociale, prezantime, postera dhe më shumë. • Burime Multimediale: Të ofrojë një bibliotekë të pasur me foto, ilustrime, ikona dhe fonte falas, duke i mundësuar përdoruesve të pasurojnë dizajnet e tyre me elemente të ndryshme. Përdoruesit të kenë akses në mbi 100 milionë foto, video, audio dhe grafikë premium, duke ofruar një gamë të gjerë burimesh për krijimin e dizajneve profesionale. • Mjete Bashkëpunimi: Platforma të ofrojë bashkëpunimin në kohë reale, duke lejuar ekipet të punojnë së bashku në projekte dizajni, duke lehtësuar komunikimin dhe rrjedhën e punës. • Asistencë Dizajni e Mundësuar nga AI: Të ketë të integruar mjete të fuqizuara nga inteligjenca artificiale, si Magic	1

		Studio, për të thjeshtuar procesin krijues duke gjeneruar sugjerime dizajni dhe automatizuar detyra, duke rritur produktivitetin e përdoruesve. Të sigurojë 1 TB hapësirë ruajtjeje, duke lejuar organizimin dhe ruajtjen e të gjitha dizajneve, videove dhe materialeve të tjera në një vend të sigurt Qasje në mbi 100 milionë foto, video, audio dhe grafikë premium. Mundësi për të krijuar disa Brand Kits për të ruajtur konsistencën e markës. Qasje e pakufizuar në shabllone premium, imazhe dhe fonte Vegla të avancuara për dizajn dhe heqës sfondi Karakteristika për bashkëpunim në ekip Ruajtje e pakufizuar në cloud për dizajne Brand Kit për menaxhimin e logos, fonteve dhe ngjyrave Përdorim i pakufizuar i shablloneve premium. Bashkëpunim në kohë reale me anëtarët e ekipit. Menaxhim i rrjedhës së miratimeve dhe ndjekje të historikut të versioneve. Shabllone dhe dosje për ekipin për organizimin e aseteve. Kontroll të qasjes së përdoruesve dhe siguri përmes SSO	
11	Paketë e avancuar softuerike për analizën e të dhënave cilësore dhe metodat e përziera -MAXQDA analytics pro	Karakteristika minimale teknike për softwarin: Analizë e dhënash cilësore dhe të përziera - Vegla vizuale për kodimin tematik dhe hartimin e të dhënave - Kompatibilitet me formate të ndryshme të dhënash (tekste, imazhe, video, etj.) - Bashkëpunim në cloud dhe menaxhim i projekteve të ekipit - Analizë statistikore e avancuar dhe vizualizim të dhënash License për të paktën 5 vjet	2
		License: 2 (single user license) Të ketë të përfshirë dhe MAXQDA TeamCloud dhe AI Assistance Premium	
12	Pointer për Prezantim	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Pointer Wireless për prezantim në distancë, 2.4 GHz USB-Receiver Red Laser Pointer 30-Meter distancë operimi 6 butona Intuitive Slideshow Control, Battery Indicator Ekuivalent me Logitech Professional Presenter	4

		R800 1. Kontroll i Prezantimit: - Distanca Wireless: Deri në 30 metra), duke ofruar fleksibilitet për të lëvizur lirshëm gjatë prezantimeve. - Kontroll Intuitiv: - Butona të lehtë për t'u përdorur për kalimin përpara/prapa dhe fshehjen e slajdeve. - Reagim i butë dhe i saktë gjatë shtypjes. - Përputhshmëria: Punon me shumicën e softuerëve të prezantimit, përfshirë Microsoft PowerPoint dhe Keynote. 2. Laser Pointer: - Laser i Gjelbër: - Shikueshmëri: Më i ndritshëm se lazerat e kuq, duke e bërë më të lehtë shikimin edhe në ekrane LCD, plazma ose në dhoma të ndriçuara. - Pamje Profesionale: Shton sofistikim dhe efikasitet gjatë prezantimeve. 3. Ekran LCD me Kohëmatës: - Funksionaliteti i Kohëmatësit: - Vendosni kohëmatës për të menaxhuar kohën në mënyrë efektive. - Alarmet me dridhje për kujtesa të heshtura kur koha po mbaron. - Tregues të Statusit: Tregon jetëgjatësinë e baterisë, sinjalin wireless dhe statusin e kohëmatësit. 4. Teknologjia Wireless: - Teknologjia: Lidhje wireless 2.4 GHz që siguron një përvojë të besueshme dhe pa ndërhyrje. - Marrësi: Marrësi kompakt USB që mund të ruhet brenda pajisjes për portabilitet. 5. Fuqia: - Bateria: Punon me dy bateri AAA me jetëgjatësi të madhe për përdorim të zgjatur (të përfshira). - Tregues i Baterisë: Paralajmëron kur niveli i baterisë është i ulët. 6. Dizajni: - Ngjyra: elegant i zi për një pamje profesionale	
13	Sistem Zëri	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Surround Sound System Sound Bar for TV	1

		3D Soundbar Home Theatre System me Adjustable Wireless Subwoofer dhe Rear Speakers, Bluetooth TV Virtual Surround Sound Speakers Sistem Audio: Të Përfshijë një soundbar, një subwoofer pa tel dhe dy altoparlantë të pasmë, duke ofruar një përvojë të plotë të tingullit rrethues që sjell thellësi dhe qartësi në audion tuaj. Teknologjia SurroundX: Të konvertojë audion standarde 2.0 PCM në tingull rrethues 5.1, duke krijuar një ambient zhytës ku tingulli lëviz për rreth. Teknologjia BassMX: Dizajni i avancuar i qarkut magnetik të subwoofer-it siguron bas të thellë dhe të fuqishëm, duke pasuruar përvojën tuaj të dëgjimit. Nivele të Rregullueshme të Surround dhe Basit: Personalizoni ambientin tuaj audio duke rregulluar në mënyrë të pavarur volumin e surround-it dhe basit sipas preferencave tuaja. Modalitete të Ndryshme EQ: Ndërrimi midis modaliteteve të paracaktuara si Filmi, Muzika dhe Dialogu për të optimizuar cilësinë e tingullit për lloje të ndryshme përmbajtjeje. Opsione të Shumta Lidhjeje: Sistemi mbështet Bluetooth 5.3, HDMI eARC-2.1, Optical (OPT), Auxiliary (AUX) dhe USB, duke siguruar kompatibilitet me një gamë të gjerë pajisjesh. Instalim i Lehtë dhe Vendosje e Përshtatshme: Fuqia Totale e Daljes: 320 Watt Peak Power Përmasat e Soundbar-it: 15.75 inç (D) x 3.54 inç (G) x 2.76 inç (L) Subwoofer: Pa tel me nivele të rregullueshme të basit Altoparlantë të Pasmë: Dy altoparlantë me kablllo me nivele të rregullueshme të surround-it ekuivalent me ultimea sound bar	
14	Robot	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: 3-ne-1 Robot, - Building Robot Kit, Robot i programueshëm me Scratch dhe Arduino, APP Control, Build Educational Robot Një komplet robotik programues 3-në-1, i projektuar për të prezantuar me konceptet STEM, duke përfshirë kodimin, robotikën dhe elektronikën. Karakteristikat Kryesore: Tre Konfigurime:	5

		- Land Raider: Një tank robotik i aftë për të lëvizur në terrene të ndryshme. - Dashing Raptor: Një makinë garuese me tre rrota, e njohur për shpejtësinë dhe manovrueshmërinë e saj. - Nervous Bird: Një robot që balancohet vetë, duke ruajtur stabilitetin gjatë lëvizjes. - Platforma Programimi: - Bazuar në Scratch, të ofrojë një ndërfaqe grafike programimi të përshtatshme për fillestarët. - Për përdoruesit më të avancuar, të lejojë programimin në Arduino C, duke mundësuar një kuptim më të thellë të kodimit. - Sensorë dhe Aktuatorë: - Të jetë i pajisur me sensor ultrasonik, sensor ndjekës linje, sensor drite, sensor zëri, xhiroskop dhe sensor temperature, duke mundësuar sjellje interaktive dhe reaguese. - Opsione Kontrolli: - Të kontrollohet përmes smartfonëve, tabletëve ose kompjuterëve duke përdorur lidhje Bluetooth ose USB, duke ofruar fleksibilitet në operim. Specifikimet: - Bordi Kryesor i Kontrollit: - Me Auriga (bazuar në Arduino Mega 2560) - Furnizimi me Energji: - Të përfshijë 6 bateri AA ose një bateri të rikarikueshme LiPo - Materialet: - Të jetë i ndërtuar nga komponentë plastikë dhe çeliku të qëndrueshëm - Përputhshmëria: - Të jetë i përputhshëm me blloqet LEGO dhe komponentët Makeblock, duke lejuar mundësi të zgjeruara ndërtimi.	
15	Projektor Mini i Lëvizshëm me Rezolucion 1080P	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Projektor 4K me WiFi dhe Bluetooth Projektor Mini i Lëvizshëm me Rezolucion 1080P, Përdorim me Një Klikim, Aplikacione të Integruara Netflix/YouTube/Prime Video/Disney+, Projektor i Mençur për	1

		ambjente të mbyllura dhe Ambjente të Jashtme - i Bardhë Karakteristikat Kryesore: 1. Ekran dhe Rezolucion: • Rezolucioni Natyral: 1080P, me mbështetje për përmbajtje 4K për pamje të qarta dhe të detajuara. • Madhësia e Projekcionit: Projekton ekran nga 40 deri në 200 inç, ideal për përdorim brenda dhe jashtë. • Ndriçimi dhe Kontrasti: Nivele të larta të ndriçimit dhe kontrastit për ngjyra të gjalla dhe detaje të mprehta. 2. Lidhshmëria: • WiFi: WiFi i integruar me dy breza (2.4GHz/5GHz) për transmetim pa probleme. • Bluetooth: Bluetooth i integruar për lidhje me altoparlantë ose kufje wireless për përvojë audio të përmirësuar. • Portat: Përfshin HDMI, USB dhe AUX për lidhje të ndryshme me pajisje të jashtme. 3. Karakteristika të Zgjuara: • Aplikacione të Parainstaluara: Netflix, YouTube, Prime Video dhe Disney+ të integruara për akses të shpejtë në përmbajtje të preferuar. • Sistemi Operativ: Ndërfaqe e zgjuar për navigim dhe menaxhim të përmbajtjes. • Përputhshmëria: I përputhshëm me pajisje të ndryshme si smartfonë, laptopë, konzola lojërash etj. 4. Audio: • Altoparlantë Stereo: Altoparlantë të integruar me cilësi të lartë për tinguj të pasur dhe zhytës. • Dalje Audio: Mbështet sistemet audio të jashtme përmes Bluetooth ose AUX për një përvojë si në kinema. 5. Portabiliteti dhe Dizajni: • I Lëvizshëm: Dizajn kompakt dhe i lehtë për t'u transportuar dhe instaluar kudo. • Përfundim Elegant: Ngjyra moderne që përshtatet me çdo ambjent të brendshëm ose të jashtëm. • I Thjeshtë për Përdorim: Instalimi i shpejtë me funksionim me një klikim. 6. Fuqia dhe Qëndrueshmëria: • Jetëgjatësia e Llambës: Deri në 50,000 orë përdorim për besueshmëri afatgjatë.	
--	--	---	--

		• Efikas në Energji: Projektuar për konsum të ulët të energjisë pa kompromentuar performancën. • Të përfshijë telekomandën dhe ☐ 1*HDMI Cable & 1*Power Adapter with Cable • Garancia 2 vite	
16	Stabilizues imazhi 3-Aksësh për GoPro Hero	Karakteristika minimale teknike për pajisjen: Stabilizues imazhi: Stabilizim 3-Aksësh: Siguron video pa dridhje duke stabilizuar lëvizjet e pjerrësisë, rrotullimit dhe panoramimit. Algoritme Precize: Algoritme të avancuara për stabilitet maksimal në mjedise dinamike. 2. Përputhshmëria: Mbështetje për Modelet GoPro: I përputhshëm me GoPro Hero 13, 12, 11, 10, dhe 9. Mbështetje për Kamera të Tjera: Punon me kamerat Osmo, Insta360, dhe kamera të tjera aksioni me dizajne të ngjashme. 3. Dizajn Rezistent ndaj Ujit: Vlerësimi IPX4: Ofron mbrojtje kundër spërkatjes, i përshtatshëm për përdorim në shi të lehtë ose pranë ujit, ideal për aventurat në natyrë. 4. Funksione Kontrolli: Kontroll Bluetooth: Kontroll i integruar përmes Bluetooth-it për të nisur/ndaluar regjistrimin dhe për të rregulluar cilësimet pa kablo. Mënyra të Ndryshme Regjistrimi: Përfshin pan-follow, pan-tilt-follow dhe all-lock për stile të ndryshme të regjistrimit. 5. Ndërtim dhe Ergonomi: I Lehtë dhe i Qëndrueshëm: Materiale të cilësisë së lartë për transportueshmëri dhe qëndrueshmëri. Kapje Ergonomike: Dizajn komod për përdorim të gjatë gjatë regjistrimeve. 6. Bateria dhe Fuqia: Jetëgjatësia e Baterisë: Performancë e zgjeruar e baterisë për orë të tëra përdorimi të vazhdueshëm. Rikarikueshme: Mbështetje për karikim USB për lehtësi. 7. Karakteristika Shtesë: Sistem Montimi i Shpejtë: Vendosije e lehtë dhe mekanizëm i sigurt për kamerat. Përputhshmëri me Aksesoret: Lejon shtimin e montimeve ose aksesoreve të tjera. 8. Përdorim Ideal: Perfekt për vlogging, udhëtime, sporte në natyrë dhe videografi profesionale.	2

		Përmirëson pamjet aksion me stabilizim dhe kontroll profesional.	
17	Projektor 4K PRO-UHD me 2,800 Lumen, Projektor Smart me Android TV	Projektor 4K PRO-UHD Android TV, 4K PRO-UHD me 2,800 Lumen, Projektor Smart me Android TV Karakteristikat Kryesore: 1. Ekran dhe Rezolucion: 4K PRO-UHD: Ofron imazhe të mprehta dhe të detajuara me mbështetje për rezolucion 4K për një përvojë zhytëse. Ndriçimi: 2,800 lumen për pamje të gjalla, edhe në dhoma me ndriçim të lartë. Raporti i Kontrastit: Kontrast dinamik i lartë për të zeza të thella dhe ngjyra të ndritshme. Madhësia e Projekcionit: Mbështet ekran deri në 500 inç, ideal për kinema shtëpiake ose ambiente të mëdha. 2. Lidhshmëria: Integrimi me Android TV: Siguron akses në aplikacione si Netflix, YouTube dhe Prime Video. Lidhje Wireless: Wi-Fi i integruar për transmetim të pandërprerë dhe shkarkim të aplikacioneve. Portat: Përfshin HDMI, USB dhe AUX për pajisje të ndryshme. Mbështetje Bluetooth: Lidhet me pajisje audio të jashtme për tingull të përmirësuar. 3. Audio: Altoparlant i Integruar: Me altoparlant të brendshëm për riprodhim audio të përshtatshëm. Dalje Audio: Mbështet altoparlantët e jashtëm për një përvojë tingulli rrethues. 4. Performanca dhe Përdorshmëria: Teknologji për Ndërrhyrje Kadrash: Redukton turbullimin e lëvizjes për riprodhim më të qetë të videove. Jetëgjatësia e Llampës: Deri në 10,000 orë përdorim në modalitetin eko. Vendosje e Lehtë: Përfshin korrigjim të pjerrësisë vertikale dhe horizontale për përshtatje perfekte. 5. Dizajni dhe Portabiliteti ekuivalent me Epson EH-TW6250: Kompakt dhe i lehtë: Lehtë për t'u lëvizur dhe instaluar në hapësira të ndryshme. Dizajn Elegant: Estetikë moderne që përshtatet me çdo ambient. 6. Përdorim Ideal: Perfekt për entuziastët e kinemasë shtëpiake, lojtarët dhe fansat e sportit që kërkojnë përvojë	1

		të madhe ekrani. Mjaftueshëm i gjithanshëm për prezantime dhe përdorim profesional.	
18	Paketë burimesh (kursesh) online për bizneset ekuivalente me udemy business	Plan ekuivalente me Udemy Business i krijuar për organizata të vogla dhe ekipe që kërkojnë një zgjidhje efektive për zhvillimin profesional dhe përmirësimin e aftësive. Ky plan të ofrojë akses në një koleksion të përzgjedhur kursesh dhe mjete për menaxhimin dhe matjen e suksesit të mësimdhënies brenda një ekipi për një përdorues për një vit. Karakteristikat Kryesore: Numri i përdoruesve: Nga 5 deri në 20 përdorues. Koleksioni i Kurseve: Akses në mbi 12,000 kurse të përzgjedhura nga ekspertë të industrisë në fusha si teknologjia, menaxhimi, aftësitë e buta (soft skills), dhe më shumë.	1
19	Mjet për menaxhimin e projekteve ekuivalent me Microsoft Project Standard	Mjet për menaxhimin e projekteve, i krijuar për të ndihmuar përdoruesit të planifikojnë, organizojnë dhe menaxhojnë projektet e tyre në mënyrë efektive. Për 1 licencë të vetme	1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

KONTRATË FURNIZIMI

(DRAFT FORMULARI I KONTRATËS)

Lidhur midis palëve të mëposhtme:

Autoriteti Kontraktor: UNIVERSITETI I TIRANËS, përfaqësuar nga Administratori, Z. Skerdi DAFA, me adresë Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, me Nipt J61915033D, nga njëra anë,

dhe

Kontraktuesi: “.....”, përfaqësuar nga Administratori, Z/Zj....., me adresë, me NIPT, nga ana tjetër.

Neni 1: Subjekti i kontratës

Subjekti i kontratës është furnizimi me objekt **“Blerje pajisje elektronike”**, në Tiranë, Albania.

Kontraktuesi do të ekzekutojë detyrat që i janë caktuar në përputhje me specifikimet teknike bashkangjitur kontratës (Aneksi II).

Neni 2: Vlera e kontratës

Kjo kontratë, e shprehur në Euro, është një kontratë me çmim global.

Vlera totale e kontratës për zbatim është: (...) **Euro pa TVSh** dhe/ose (...) **Euro me TVSh**, sipas ofertës së paraqitur (Annex I). Çmimi nuk mund të rishikohet.

Neni 3: Dokumentet kontraktuese

Dokumentet që bëjnë pjesë në këtë kontratë janë (sipas rendit të përparësisë):

- oferta financiare (Annex I);
- specifikimet teknike (Annex II)

Neni 4: Dispozita të përgjithshme

Kontraktuesi do të ekzekutojë kontratën me kujdesin e duhur, efikasitetin dhe përkushtimin në përputhje me praktikën më të mirë profesionale.

Detyrimet e përgjithshme të Aplikantit janë të përcaktuara në specifikimet teknike (Aneksi II), që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Neni 5: Furnizimi dhe pagesat

Kontraktuesi do të ofrojë pa rezerva furnizimin sipas ofertës financiare “Aneksi I”. Furnizimet do të zbatohen brenda periudhave të treguara.

Autoriteti kontraktues do t'i paguajë kontraktuesit shumën e treguar në nenin 2 të kësaj kontrate. Nuk aplikohen pagesa paraprake. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të të gjitha detyrimeve që dalin nga kjo kontratë, shoqëruar me raporte/pv dhe faturën/at tatimore, që tregon përshkrimin e shërbimit, sasinë, çmimin për njësi dhe shumën totale, brenda 30 ditëve nga pranimi.

Pagesa do të bëhet në Bankën _____, ACCOUNT no. _____ IBAN no. _____ në Euro, të cilën Kontraktuesi i ka vënë në dispozicion Autoritetit Kontraktues.

Kjo kontratë i nënshtrohet tatimit sipas kuadrit të legjislacionit kombëtar të Shqipërisë.

Neni 6: Kohëzgjatja e kontratës

Afati i realizimit të furnizimit, do të jetë 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 7: Anulimi i kontratës

Kontrata mund të pezullohet nga Kontraktuesi për një nga arsyet e mëposhtme:

- Autoriteti Kontraktues nuk përmbush pagesën dhe detyrimet e tjera.

Kontrata mund të përfundojë nga Autoriteti Kontraktues për një nga arsyet e mëposhtme:

- Kontraktuesi është në shkelje serioze të kontratës, duke mos përmbushur detyrimet kontraktuale.
- Kontraktuesi është i falimentuar ose po përfundon, po administron çështjet e tij nga gjykatat, ka hyrë në aranzhime me kreditorët, ka pezulluar aktivitetet e biznesit, është subjekt i procedimeve në lidhje me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që vjen nga një situatë e ngjashme të parashikuara në legjislacionin ose rregulloret kombëtare.

Neni 8: Gjuha e kontratës

- Gjuha e kontratës dhe e të gjitha komunikimeve me shkrim ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor dhe/ose menaxherit të projektit do të jetë shqip.

Neni 9: Kushte të tjera specifike që zbatohen për kontratën

- Nuk zbatohen kushte të tjera specifike për kontratën

Neni 10: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ose lidhet me këtë Kontratë, e cila nuk mund të zgjidhet ndryshe, do t'i referohet juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Përpiluar në gjuhën shqipe dhe angleze në 4 (katër) kopje origjinale për secilën, tre origjinale janë për autoritetin kontraktues dhe një origjinal është për kontraktuesin.

Për Kontraktuesin

Emri:

Titulli: Administrator

Nënshkrim:

Data:

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:

Skerdi DAFA

Titulli:

Administrator

Nënshkrimi:

Data: